



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

1. Sa çështje janë shqyrtuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes, për secilin nga vitet 2021, 2022 dhe 2023? Sa nga këto çështje janë iniciuar *ex-officio* dhe sa prej tyre në bazë të ankesave? Do vlerësonim informimin mbi kategorinë e subjekteve që kanë adresuar ankesa mbi gjuhën e urrejtjes (pra nëse janë qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, institucione të tjera partnere etj).

*Gjatë vitit 2021*, nga ana e Komisionerit janë shqyrtuar 7 çështje, nga të cilat 6 ankesa dhe 1 *ex-officio*, me objekt gjuhën e urrejtjes. Referuar çështjeve të trajtuara në 5 raste informacioni i marrë (ankesa) është përcjell nga ana e OJF-ve (përfaqësues të shoqërisë civile) dhe në 2 raste nga ankues (qytetarë).

*Gjatë vitit 2022*, nga ana e Komisionerit janë shqyrtuar 6 çështje, nga të cilat 4 ankesa dhe 2 *ex-officio*, me objekt gjuhën e urrejtjes. Referuar çështjeve të trajtuara në 1 rast informacioni është marrë nga media, për iniciimin e çështjes *ex-officio*, në 2 raste informacioni (ankesa) është përcjell nga ana e OJF-ve (përfaqësues të shoqërisë civile) dhe në 3 raste nga ankues (qytetarë).

*Gjatë vitit 2023*, nga ana e Komisionerit janë shqyrtuar 7 çështje, nga të cilat 6 ankesa dhe 1 *ex-officio*, me objekt gjuhën e urrejtjes. Referuar çështjeve të trajtuara në 5 raste informacioni i marrë (ankesa) është përcjell nga ana e OJF-ve (përfaqësues të shoqërisë civile) dhe në 2 raste nga ankues (qytetarë).

2. Në sa nga këto raste, gjatë periudhës 2021-2023 Komisioneri është shprehur me vendim dhe ka konstatuar diskriminim në formën e “*gjuhës së urrejtjes*”, me objekt:
  - a. gjuhë e urrejtjes me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor;
  - b. gjuhë e urrejtjes me bazë etninë;
  - c. gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë fetare;
  - d. gjuhë e urrejtjes bazuar në përkatësinë politike;

*Gjatë vitit 2021, në përfundim të shqyrtimit të çështjeve me objekt gjuhën e urrejtjes Komisioneri është shprehur si më poshtë:*

- 2 Vendime Diskriminimi (1 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor; 1 me shkak racën dhe etninë);
- 2 Vendime Arritje Efektiviteti (1 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor; 1 me shkak racën dhe etninë);
- 3 Vendime Mosdiskriminimi (3 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor).

*Gjatë vitit 2022, në përfundim të shqyrtimit të çështjeve me objekt gjuhën e urrejtjes Komisioneri është shprehur si më poshtë:*

- 2 Vendime Diskriminimi (1 me shkak gjininë; 1 me shkak racën dhe etninë);
- 1 Vendim Mosdiskriminimi (1 me shkak besimin fetar);
- 1 Vendim Mospranimi (1 me shkak gjendjen shoqërore);
- 1 Vendim Pushimi/Braktisje (1 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor).

*Për vitin 2022, për 1 ankesë dhe 1 çështje ex-officio, Komisioneri ka dalë me 1 vendim të përbashkët diskriminimi.*

*Gjatë vitit 2023, në përfundim të shqyrtimit të çështjeve me objekt gjuhën e urrejtjes Komisioneri është shprehur si më poshtë:*

- 1 Vendim Diskriminimi (1 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor);
- 4 Vendime Mosdiskriminimi (2 me shkak orientimin seksual dhe identitetin gjinor; 2 me shkak racën dhe etninë);
- 1 Vendim Mospranimi (1 me shkak bindjet fetare);
- 1 çështje është në proces shqyrtimi (me shkak bindjet fetare).